



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**

E K S T R A K T
i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, mbajtur më dt. 20.06.2022, duke filluar
në orën 12:00

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi - Rexha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Faton Marolli, Arton Brahimi dhe Adnan Ajeti.

Mungoi: Triera Kasumi Berisha.

Në mbledhje morë pjesë edhe: Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Klaudia Mula, koordinatore për komunitetë në ZKKK-s, Betim Abdullahu, U.D shef i ZKKK-s, përfaqësuesit e KFOR-t.

Mbledhjen e hapi dhe e kryeso,i kryesuesja e Komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D D I T E

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Ilirik Musliu;**
3. **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit, z. Arbër Sadiki;**
4. **Miratimi i Planit gjashtëmuajor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022;**
5. **Raporti i ZKKK-s për muajin Maj 2022 dhe prezantimi i projekteve për investime kapitale dhe miratimi tyre;**
6. **Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;**
7. **Të ndryshme.**

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit nga procesverbalit i mbledhjes së kaluar
Njëzéri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Ilirik Musliu

Mirsada Behluli – duke përvendetur drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Ilirik Musliu, ajo në vazhdim e njoftoi lidhur me problemin e linjës së autobusit 7c, ku në emër të vetin dhe në emër të banorëve të lagjes Kalabria, njoftoi drejtorin lidhur me problemin e linjës së autobusit 7C, ku kërkon që nëse ka mundësi që vend ndalja të jetë më afër, ku zgjidhja e mundshme do të ishte parkingu ekzistues tek Viva Fresh Store.

Ilirik Musliu – lidhur me propozimin e z. Miladinovic tha se në këtë rast ne mundemi të koordinohemi që të kemi takime javore me ZKKK-s, gjegjësisht të kemi takime në mes ZKKK-s dhe shefave të sektorëve gjë që do të ishte mirë, pasi që kërkesat janë të shumta dhe të ndryshme, ashtu që çdo kërkesë do të shkonte në sektorin përkatës.

Nenad Miladinovic – shtroi disa probleme me të cilat ballafaqohet një kohë të gjatë e ato janë: si problem i parë është kanalizimi në Bërnicën e Poshtme i cili në kohën e fundit na shfaq probleme të mëdha pasi që derdhet nëpër oborre të banorëve që paraqet edhe rrezik prej ndonjë epidemie, gjë që për këtë kam informuar Drejtorin e Investimeve Kapitale e cila ka dal në terren së bashku me policinë aty ka qenë edhe ekipi i Ujësjellësit dhe ai i Inspektionit, ku kanë bërë njëfarë marrëveshje dhe më kanë thënë se kjo do të rregullohet brenda 3-4 ditëve mirëpo ende nuk është ndërmarrë asgjë.

Problemi i dytë është çështja e ndriçimit mirëpo po e shoh se keni bërë marrëveshje për të cilën më vjen mirë dhe besoj se do të fillohet të punohet në atë drejtim.

Problemi i tretë është se në rrugën Podujevë – Prishtinë në mes është kthesa për Bërnicë dhe mu aty ndalet autobusi gjë që shkakton rrezik, ku edhe ka pasur disa aksidente. Prandaj kisha me ju lutur që mundësisht vend ndalja të jetë bile 50 metra ma andej pra më lartë.

Çështja tjetër është vendosja e shenjave të komunikacionit ku besoj se së shpejti do të vendosen pasi që është kërkesë e kah hershme.

Çështja tjetër e cila paraqet problem të madh është çështja e mbeturinave ku ju kisha lutur që të ndërmerrni masa, meqë për këtë është e njoftuar edhe policia e cila ka shqiptuar disa gjoba.

Si dhe çështja tjetër është kërkesa për kyçjen ujit në rrjetin e Ujësjellësit për banorët e fshatit Slivovë.

Ilirik Musliu – duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Miladinovic tha se në momentin kur kemi ardhur ne i kemi trashëguar të dy kontratat në OSHP, d.m.th se asnjë kontratë nuk e kemi pasur. Mirëpo ajo e ndriçimit është nënshkruar javën e kaluar, ndërsa këtë javë jemi në vlerësimin e kontratave të sinjalizimit shenjëzues që besoj se brenda dy jave do ta kemi gati kontratën dhe kemi me i trajtuar të gjithat.

Ndërsa sa i përket kyçjes së ujit në rrjetin e Ujësjellësit për banorët e fshatit Slivovë duhet të konsultohemi me Ujësjellësin se çka mundemi me bërë në atë drejtim.

Kurse sa i përket mbeturinave ju kisha lutur që të na tregoni vendin e saktë qysh kishim me e dërguar ekipin për verifikim.

Betim Abdullahu - duke u ndërlidhur me çështjen e projekteve tha se sikurse çdo herë ne si ZKKK-s i kemi njoftuar të gjithë anëtarët e komuniteteve që me na i sjell projektet dhe me i miratuar në mbledhje qysh kishim me i dërguar pastaj nëpër drejtorit përkatëse. Ku edhe në mbledhjen e kaluar të Komitetit për Komunitete i kemi njoftuar të gjithë anëtarët e komuniteteve të na i sjellin projektet të cilat kanë të bëjnë me Investimet Kapitale, pasi që ne si Zyre kemi një buxhet prej afér 100 milionë euro por të cilat i kemi të dedikuara vetëm për Investime Kapitale e jo për drejtori tjera. Por nuk do të thotë se i anashkalojmë drejtoritë e tjera se siç e ceka më herët ne i kemi 100 milion euro të dedikuara vetëm për investime kapitale.

Ilirik Musliu - lidhur me diskutimin e z. Abdullahu tha se në këtë rast me Drejtorin e Shërbimeve Publike është më lehtë për arsyen se nuk duhet buxhet, as nuk na nevojitet projekt, pra na nevojiten kërkesa, ankesat me ardhur, ne i kemi kontratat në kuadër të drejtorisë e njoftojmë operatorin dhe ndërhyjmë. Ai në vazhdim tha se besoj se deri në fund të muajit do ti nënshkruajmë të gjitha kontratat dhe do të jemi në dispozicion për çdo ndërhyrje që i përket drejtorisë tonë.

Adnan Ajeti - shtroi shqetësimin lidhur me mbeturinat të cilat grumbullohen në lagjen ku ai jeton d. m. th në rr. "Xhem Gostivari" në Prishtinë, pastaj me hapjen e gropave gjatë vendosjes së gypave të ujit e të cilat nuk janë mbuluar si dhe me ndriçimin.

Ilirik Musliu - duke iu përgjigjur z. Ajeti tha se sa i përket gypave të ujit do të konsultohemi me Ujësjellësin për rregullimin ndërsa sa përket mbeturinave do të ju lutesha që të më tregoni saktë vendin qysh kishim me e dërguar ekipin, si dhe sa përket ndriçimit do ta rregullojmë menjëherë pasi që ta nënshkruajmë kontratën.

Faton Marolli - shtroi problemin se në pjesën ku lidhen rruga "Bedri Gjini" dhe "Verat e Llukës" ka filluar të kundërmoj era si pasojë e kanalizimit të ujërave të zeza. Meqë ekipi ka intervenuar por era prapë po kundërmon. Ku për këtë kam edhe peticionin e banorëve nga të dy komunitetet nga komuniteti ashkali dhe ai shqiptar të cilët jetojnë në atë pjesë. Ai në vazhdim tha se me 15 Shkurt atë pjesë e ka vizituar edhe kryetari z. Përparim Rama, ku edhe ai vet e ka vërejtur se ajo pjesë nuk pastrohet fare.

Ai mes tjerash ceki edhe problemin e mbeturinave ku thotë se mbeturinat merren çdo të premte por ajo pjesë nuk pastrohet, ku përveç kësaj ai ceki edhe peticionin e banorëve ku kërkojnë që të vendosen policët e shtruar në rrugë për shkak qarkullimit të madh të veturave të cilat kalojnë me shpejtësi të madhe pasi që aty lidhet edhe rruga e Caralevës.

Oktay Kurtesh - tha se po ashtu edhe ne në rrugën "Bedri Gjini" dhe "Nazim Gafuri" kemi problem me kanalizimin pasi që kur bie shi krejt aji uji vjen prej "Tauk Bashqes" meqë kapakët e kanalizimit janë por si duket ata nuk funksionojnë. Meqë nuk është hera e parë që e kemi shtruar këtë problem dhe kemi bërë kërkesë, por më duket se kjo pjesa e vjetër e qytetit është anashkaluar dhe anashkalohet tutje.

Ai njëherit shtroi edhe problemin e mbeturinave në rrugën "Bajram Kelmendi", pasi që me të vërtet i jepin një pamje të keqe qytetit, ku dhe shtroi pyetje se a ka mundësi që të vendosen shportat e mbeturinave në rrugën "bajram Kelmendi", "Ibrahim Lutfiu", "Nazim Gafuri" dhe tek Shkolla filllore "Elena Gjika".
Ai përveç këtyre shtroi edhe problemin e qenve endacak.

Ilirik Musliu- sa i përket kanalizimit tha se ajo i përket Ujësjellësit por do e marrim ne përsipër dhe do ua përcjellim kërkesën.

Ndërsa sa i përket mbeturinave tha se këtu e kam foton që më ka dërguar kryetari i cili ka qenë në terren, ku këtë javë kemi me dal në terren dhe me ndërmarr si lokacion.

Kurse sa i përket qenve endacak tha se problemi është nacional dhe regional dhe nuk mundemi si Prishtinë me trajtuar këtë temë pasi që nuk mundemi ta zgjedhim.

Ai njëherit tha se ju e dini se ne kemi problemin edhe me strehimoren të cilën Ministria na e ka refuzuar, prandaj pa u bërë strehimorja nuk ka zgjidhje.

Ai në vazhdim tha se kemi bërë një thirrje ku i kemi ndarë shtatë llote, ku Prishtinën e kemi zonuar në shtatë zona të cilat kemi me i trajtuar.

Pra kemi me i pasur shtatë operator të cilët kanë me u përgjigjur ku edhe ata vet kanë me qenë në terren si dhe në momentin kur do të kemi ndonjë kërkesë apo ankesë nga qytetarët ata kanë me reaguar

Mirsada Behluli – nëse nuk ka dikush tjetër që donë ta merr fjalën atëherë falënderoj drejtorin për pjesëmarrjen si dhe shpresoj se do të na ndihmoni në realizimin e kërkesave tona aq sa keni mundësi.

Pika e tretë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit z. Arbër Sadiki

Me mos mundësinë e pjesëmarrjes së drejtorit në fjalë në takim kjo pikë mbetet për mbledhjen e radhës.

Pika e katërt

Miratimi i Planit gjashtëmujor të punës së Komitetit për vitin 2022

Mirsada Behluli – materialin e keni marr të gjithë dhe me siguri e keni lexuar, ka dikush ndonjë vërejtje apo të shtonë diçka.

Nenad Miladinovic – lidhur me Planin gjashtëmujor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022 tha se në përpilimin e këtij plani kemi marr pjesë unë, znj. Mirsada Behluli – kryesuesja e Komitetit për Komunitete, znj. Kimeta Shok dhe znj. Klaudia Mula, ku gjatë përpilimit të këtij plani jemi munduar që ti përfshijmë të gjithat që janë me rëndësi.

Ai në vazhdim tha se ky plan i punës është vetëm një udhëzues për punën e Komitetit. Ndërsa sa i përket pyetjes se a ka diçka të shtohet ai tha se kur të përpilohet rendi i ditës atëherë mund të shtohet nëse ka diçka për tu shtuar.

Mirsada Behluli – kush është për miratimin e Planit gjashtëmujor të punës së Komitetit për Komunitete.

Njëzëri u miratua Plani gjashtëmujor i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

Pika e pestë

Raporti i ZKKK-s për muajin Maj 2022 dhe prezantimi i projekteve për investime kapitale dhe miratimi i tyre

Klaudia Mula – sa i përket Raportit të ZKKK-s për muajin Maj 2022, tha se fokus i veçantë ka qenë zbatimi i projekteve për shpërndarjen e pakove për fëmijët e familjeve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, si dhe shpërndarja e materialit higjenik për familjet e komuniteteve në përgjithësi.

Mirsada Behluli – lidhur me shpërndarjen e pakove tha se vitin e kaluar ka qenë shpërndarja e pakove në vlerë prej 20 kilogramëve për të cilat familjet të cilat i kanë marr kanë qenë të kënaqur dhe falënderuese.

Andaj shtroi pyetje se a ka mundësi që të përsëritet organizimi i atyre pakove edhe gjatë këtij viti.

Raporti përmban edhe pjesën për investime kapitale.

Klaudia Mula – tha se me siguri do të përsëritet pasi që vetëm është nënshkruar kontrata edhe për pako ushqimore, që do të thotë se do të jenë dy pako njëra do të jetë pako ushqimore kurse tjetra pako higjenike.

Tani ia jap fjalën z. Nenad që ti prezantoj projektet.

Nenad Miladinovic – sa i përket projekteve tha se kemi dy projekte ku njëri projekt ka të bëjë me atë që e prezantova pak më herët para drejtorit, pra kyçjen e ujit në rrjetin e Ujësjellësit për banorët e fshatit Slivovë dhe projekti tjetër është rregullimi i rrugës kryesore në Bërnicën e Poshtme që kur është punuar kanalizimi rruga është dëmtuar aq shumë sa që kanë mbetur gropë të mëdha. Pra krejt kjo ka të bëjë me pjesën ku qarkullon linjave autobusit Bardhosh – Bërnicë e Poshtme – Prishtinë, d. m. th në pyetje janë 2 kilometra.

Ai mes tjerash tha se sa i përket projektit për banorët e fshatit Slivovë mundemi të dalim në terren dhe të verifikojmë se sa do të jenë investimet cilës drejtori i takojnë Shërbimeve Publike apo Investimeve Kapitale dhe sa banorë janë aty.

Klaudia Mula – tha se ky projekt ndoshta është shumë i vogël por është problem shumë i madh për disa familje që nuk e kanë të kyçur ujin brenda.

Ai është projekt multi etnik sepse aty janë 4-5 shtëpi të komunitetit serb kurse të tjerat janë të komunitetit shqiptar.

Njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-s për muajin Maj 2022.

Pika e gjashtë

Raportimi i nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre

Mirsada Behluli - sa i përket komunitetit boshnjak nuk kemi kurrfarë problemi.

Nenad Miladinovic- sa i përket komunitetit serb nuk kemi kurrfarë problemesh edhe pse ajo pjesë është pjesa më e madhe multietnike, ku ndoshta arsyeva është se me z. Hetem Kupina që është kryetar i bashkësisë Lokale të asaj pjese punojmë shumë në atë drejtim. Po ashtu bashkëpunim të mirë kemi edhe me komandimin e policisë të asaj pjese. Mirëpo më duhet ta ripërsëris problemin e kanalizimit i cili derdhet në oborret e banorëve dhe paraqet rrezik përfshirë.

Kimeta Shok - sa i përket komunitetit goran nuk kemi kurrfarë probleme.

Adnan Ajeti - po ashtu as tek komuniteti rom nuk kemi probleme sa i përket sigurisë.

Oktay Kurtesh - sa i përket komuniteti turk nuk kemi kurrfarë problemesh sa i përket sigurisë.

Faton Marolli - po ashtu as tek komuniteti ashkali nuk kemi probleme sa i përket sigurisë.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Klaudia Mula - të pranishmit i informoi se gjatë javës kanë pasur takim me Zyrën për çështje të komuniteteve pranë Zyrës së kryeministrat, dhe se Qeveria ka marr tentim për punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas si dhe për komunitetet tjera. Ajo në vazhdim tha se ata kërkojnë nga niveli lokal listat me të dhënat e sakta të rindjeve të cilët janë të aftë përfshirë.

Prandaj kisha me kërkuar nga të gjitha komunitetet që ti përpilojnë listat dhe ti sjellin tek unë në Zyra, ku ne do të jemi në kontakt me Zyrën për çështje të komuniteteve pranë kryeministrat dhe do ti dërgojmë ato lista.

Ajo të pranishmit i njoftoi se gjatë kësaj vere do të lansohen grandet në vlerë prej 1.5 milion euro me qëllim të aktivitetave kulturore, për promovimin e të drejtave të komuniteteve, mediat e komuniteteve.

Ajo njëherit të pranishmit i informoi dhe me një informatë që është me rëndësi se në Fakultetin Filologjik është hapur një degë e re apo program që quhet Ballkanistika, dhe se aty është një mundësi e mirë për studentët sidomos të komuniteteve të cilët janë të interesuar përfshirë e ballkanit, ku pastaj do të certifikoheshin si mësimdhënës, përkthyes pasi që ky program ka marrëveshje me qytetet e Bashkimit Evropian.

Pas ca diskutimesh Komiteti për Komunitete nxori këtë

Faqe 6 nga 7

R E K O M A N D I M

1. Të ftohet për takimin e ardhshëm drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit z. Arbër Sadiki.
2. Të ftohet për takimin e ardhshëm drejtoresha e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.
3. Të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë ti përpilojnë listat me të dhënata e sakta të të rinxve të cilët janë të aftë për punë dhe ti dërgojnë në ZKKK-s.
4. Të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë të përgatisin listat me emrat e familjeve të cilat kanë nevojë për ndihma.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete
Dr. Mirsada Benluli

